FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2025 – Numri: 227

Tiranë – E martë, 9 dhjetor 2025

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 3.12.2025	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronave me vendndodhje në Lundër, me numër pasurie 867/2, 867/17, 867/31 dhe 867/32, zona kadastrale 2529, Tiranë.....	28443
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 723, datë 3.12.2025	Për ngritjen, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Ekipit të Përgjigjes ndaj Emergjencave dhe Krizës së Sigurisë Kibernetike.....	28446
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 724, datë 3.12.2025	Për ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 14.1.2025, për çështjen "Ibrahimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë" (për kërkesën nr. 81057/17 dhe 4 kërkesa të tjera).....	28448
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 725, datë 3.12.2025	Për një ndryshim në vendimin nr. 820, datë 13.10.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", të ndryshuar.....	28450
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 727, datë 3.12.2025	Për disa ndryshime në vendimin nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, "Për listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit", të ndryshuar.....	28454
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 728, datë 3.12.2025	Për përcaktimin e kritereve për dhënien e medaljes së shërbimit ushtarak.....	28454
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 729, datë 3.12.2025	Për emërimin në detyrë të drejtorit të përgjithshëm të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.....	28455

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 3.12.2025	Për disa shtesa në vendimin nr. 450, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe procedura e përjashtimit të tyre".....	28455
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 731, datë 3.12.2025	Për kalimin e fondit në kuadër të mbështetjes së veprimtarisë së fondacionit "Kinostudio".....	28457
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 732, datë 3.12.2025	Për lirim dhe emërim në detyrë.....	28457
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 18.11.2025	Çështja Lasku dhe të tjerë kundër Shqipërisë *(kërkesa nr. 6045/14)*.....	28457
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1255, datë 26.11.2025	Për shfuqizimin e urdhrave të ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 561, datë 4.6.2025, nr. 565, datë 5.6.2025, nr. 574, datë 9.6.2025, nr. 584, datë 11.6.2025, nr. 590, datë 13.6.2025, nr. 591, datë 14.6.2025, nr. 606, datë 18.6.2025, nr. 613, datë 23.6.2025, nr. 614, datë 23.6.2025, nr. 618, datë 25.6.2025, nr. 627, datë 26.6.2025, nr. 630, datë 27.6.2025, nr. 632, datë 30.6.2025, nr. 734, datë 30.7.2025.....	28463
Urdhër i ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 1269, datë 26.11.2025	Për formën dhe përmbajtjen e Katalogut Kombëtar.....	28464
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin nr. 1180/6, datë 3.12.2025	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Ndërtim i rrugës 'Bexhet Hyti' në ZK 2654".....	28465

VENDIM
Nr. 722, datë 3.12.2025

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE TEK FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT, TË PRONAVE ME VENDNDODHJE NË LUNDËR, ME NUMËR PASURIE 867/2, 867/17, 867/31 DHE 867/32, ZONA KADASTRALE 2529, TIRANË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve tek Fondi Shqiptar i Zhvillimit, të pronave me vendndodhje në Lundër, me numër pasurie 867/2, 867/17, 867/31 dhe 867/32, zona kadastrale 2529, Tiranë, sipas formularit dhe planit të rilevimit që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t'i përdorur për funksione publike.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi, si dhe t'i tjetërsojë ato.

3. Ngarkohen Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI/ËT: SHTET **DATË:** 20.10.2025 **QËLLIMI:** PËRDITËSIM/INVETARIZIM

VENDNDODHJA

BASHKIA: TIRANË **DVASHK/ZVASHK:** TIRANA RURALE 1 **ZONA KADASTRALE NR:** 2529 **NUMRI PASURIVE:** 867/2; 867/17; 867/31; 867/32 **INDEX HARTE:** K-34-100-(44-B, D)

TË DHËNAT E PASURISË

LLOJI PASURISË: TRUALL, OBJEKT **SIP. TOTAL PASURIVE:** 3,152 m² **SIP.TOTAL GJURMËS NDËRTIMIT:** 3,152 m² **NUMRI KATEVE:** - **NUMRI PEMËVE:** -

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X= 488515.25; Y= 4571736.99 X= 488990.24; Y= 4571736.99



X= 488515.25; Y= 4571491.01 SH 1:2500 X= 488990.24; Y= 4571491.01

Nr.	PËRDORIMI	ORIENTIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHËNIME TË REALIZUESIT
1		VERI		867/28		
2		JUG		867/29		
3		LINDJE		867/28		
4		PERËNDIM		867/21		

REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT:

EMRI: FESTIM AGRON BREGASI

LIÇENCA: T.1221 DATE: 30.03.2017

KOMPANIA:_____

NIPT:_____

NËNSHKRIMI / VULA_____

NO.GJEODET FE... T...ASI LIC T.1221

REALIZOI PËR ASHK:

SPECIALISTI_____

DVASHK_____

NËNSHKRIMI_____

KONFIRMOI:

PËRGJEGJËSI/DREJTORI_____

NËNSHKRIMI_____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T-(Terren); Z- (Zyrë)

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyrë; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash.

PËRCAKTIMI KUFIRIT: T+P+K - (Terren me Përfaqësues të Pronarëve dhe Kufitarëve)

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale

SHËNIME TË VEÇANTA_____

PRONARI/BASHKËPRONARËT-DEKLARIM MBI MARRDHËNIET ME KUFITARËT

EMRI: Ethem Kollobaku

NËNSHKRIMI_____

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ZYRA E REGJISTRIMIT TË PRONËS ZYRA E REGJISTRIMIT TË PRONËS TIRANË

Kode per teknologjine e matjeve dhe përcaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie; HK-Harta Kadastrale

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Fondi Shqiptar i Zhvillimit		Identifikoi:	**Aida Kulla** -Specialist Zyra e Miratimeve dhe Lejeve për Zhvillim
			(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Fusha e perdorimit te Prones: Sherbime Multifunksionale		Aprovoi:	**Elton Kallabaku**-Drejtor I Departamentit të Aktiveve dhe Gjenerimit të Produktit
			(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, data)

Nr.	A					B		C				
	Zona Kadastra	Nr. Pasurise	Lloji I Prones	Emri I Prones Adresa		Sip. Totale	Nga Sip. Totale:	Funksioni per te cilin	Institucioni / Enti me pergjegjesi	Institucioni / Enti perdorues	Statusi juridik i	(Shenime te vecanta)
Rend.	Indeksi I					e Prones	Sa Ndertese	perdoret Prona	administrative		perdorimit	
	Hartes					(m^2)	(m^2)					
1	2	3	4	5		6	7	8	9		10	11
1	2529	867/2	Truall+Ndertese	Tirane		976	976		Fondi Shqiptar I Zhvillimit	Fondi Shqiptar I Zhvillimit		
2	2529	867/17	Truall+Ndertese	Tirane		976	976		Fondi Shqiptar I Zhvillimit	Fondi Shqiptar I Zhvillimit		
3	2529	867/31	Truall+Ndertese	Tirane		765	765		Fondi Shqiptar I Zhvillimit	Fondi Shqiptar I Zhvillimit		
4	2529	867/32	Truall+Ndertese	Tirane		435	435		Fondi Shqiptar I Zhvillimit	Fondi Shqiptar I Zhvillimit		
		Totali				3152	3152					

VENDIM
Nr. 723, datë 3.12.2025

PËR NGRITJEN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT DHE TË FUNKSIONIMIT TË EKIPIT TË PËRGJIGJES NDAJ EMERGJENCAVE DHE KRIZËS SË SIGURISË KIBERNETIKE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 29, të ligjit nr. 25/2024, "Për sigurinë kibernetike", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. NGRITJA E EKIPIT TË PËRGJIGJES NDAJ EMERGJENCAVE DHE KRIZËS SË SIGURISË KIBERNETIKE

1. Pranë Autoritetit Kombëtar për Sigurinë Kibernetike (në vijim, AKSK-ja) ngrihet dhe funksionon Ekipi i Përgjigjes ndaj Emergjencave dhe Krizës së Sigurisë Kibernetike (në vijim, CERT-i), i cili është një strukturë *ad hoc*, rast pas rasti, përgjegjëse për trajtimin në kohë dhe me eficiencë të emergjencave dhe të krizës së sigurisë kibernetike në Republikën e Shqipërisë.

2. CERT-i kryesohet nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe përbëhet nga:

a) përfaqësues nga institucionet publike, si më poshtë vijon:

i. Ministria e Punëve të Brendshme;

ii. Ministria e Mbrojtjes;

iii. Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme;

iv. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare;

v. Shërbimi Informativ i Shtetit;

vi. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit;

vii. Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale;

viii. Policia e Shtetit;

b) ekspertë të sigurisë kibernetike, të teknologjisë së informacionit dhe ekspertë OT (*operational technology*), thirrja e të cilëve do të bëhet sipas përcaktimeve të pikave 7–12 të këtij kreu.

3. Titullarët e institucioneve, sipas shkronjës "a", të pikës 2, të këtij kreu, brenda 5 (pesë) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dërgojnë pranë AKSK-së emrat e përfaqësuesve të institucioneve të tyre, si dhe përditësojnë emrat e listës, në raste ndryshimesh, brenda 5 (pesë) ditëve nga ndodhja e këtyre ndryshimeve.

4. AKSK-ja, me urdhër të drejtorit të përgjithshëm, bazuar në situatën e emergjencës e të krizës kibernetike, rast pas rasti, duke marrë në konsideratë kompleksitetin e situatës, natyrën e sulmit, si dhe numrin e infrastrukturave të prekura, vendos për numrin e ekspertëve, që do të përfshihen në ekipin e CERT-it dhe profilet e tyre.

5. Kriteret që duhet të plotësojnë ekspertët e sigurisë kibernetike të teknologjisë së informacionit dhe ekspertët OT, për të qenë pjesë e CERT-it, janë, si më poshtë vijon:

a) Kritere të përgjithshme:

i. të kenë zotësi të plotë për të vepruar;

ii. të kenë diplomë të nivelit të gjashtë të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, "Bachelor" ose të barasvlershme me të, sipas legjislacionit për arsimin e lartë, në fushën e teknologjive të informacionit dhe komunikimit (ICT) ose në fusha të tjera, të lidhur me njohuritë e përcaktuara në shkronjën "b" të kësaj pike;

iii. të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

iv. të plotësojnë kriteret e integritetit e të besueshmërisë në ruajtjen e konfidencialitetit dhe të integritetit të informacionit, si dhe të pastërtisë së figurës;

b) Kritere profesionale:

i. të kenë përvojë pune të paktën 7 (shtatë) vjet në profesion;

ii. të kenë aftësi profesionale në fushën e sigurisë kibernetike dhe teknologjisë së informacionit;

iii. të zotërojnë njohuri të thelluara në fushën e sigurisë kibernetike dhe të teknologjisë së informacionit, si më poshtë vijon:

- njohuri për sistemet kompjuterike, virtuale dhe sistemet e operimit, si: Linux, Windows Server, sistemet virtuale, si VMWARE ose KVM, HyperV etj.;
- njohuri për protokollet e rrjeteve kompjuterike;
- njohuri për aplikacionet dhe platformat, që përdoren në rrjetet e sistemet e informacionit;
- njohuri për fushën e sigurisë së informacionit;
- taktikat, teknikat dhe procedurat (TTPs) e sulmeve kibernetike dhe aplikacioneve, që përdoren për këtë qëllim;
- njohuri mbi teknikat e hetimit kibernetik (*forensic*);

- njohuri në menaxhimin e incidenteve dhe mbrojtjen e të dhënave personale, si Log Analyst apo SIEM etj.;
- njohuri për menaxhimin e krizave kibernetike;
- njohuri në *Python*, gjuhët *Object Oriented*;
- njohuri në inteligjencën artificiale/AI, *Machine Learning*, *Blockchain*, *Cryptography*, *Autonomous Vechicles/Machines* etj.;

c) Për të vërtetuar kriteret e përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b, të pikës 5, të këtij kreu, aplikuesi duhet të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:

i. mjet identifikimi (kopje e kartës së identitetit/ pasaportës biometrike);

ii. dëshmi penaliteti, vërtetime nga gjykata që nuk është në proces gjyqësor dhe nga prokuroria që nuk është në procedim penal, si dhe vetëdeklarim që vërteton gjendjen penale;

iii. kopje të diplomës;

iv. kopje të librezës së punës ose një vërtetim nga organet tatimore, ku të jetë shënuar përvoja në profesion;

v. jetëshkrim me përvojat profesionale (CV);

vi. vetëdeklarim për integritetin dhe besueshmërinë në ruajtjen e konfidencialitetit dhe integritetit të informacionit;

vii. kopje të certifikimeve në fushën e sigurisë kibernetike dhe teknologjisë së informacionit;

viii. përbën avantazh paraqitja e certifikimeve, si vijon:

- certifikime në administrim rrjetesh dhe menaxhim sistemesh;
- certifikim në administrim të sistemeve të sigurisë së informacionit;
- certifikim profesional të sigurisë kibernetike, të tilla si: Security+, CISA, CISSP, CISM, CEH, OSCP, CHFI ose ekuivalente;
- certifikime për menaxhimin e incidenteve kibernetike;
- certifikime për investigimin e incidenteve dhe ekzaminimin digjital;
- certifikime në inteligjencën artificiale/AI;
- certifikime në *Machine Learning*;
- certifikime në *Blockchain*;
- certifikime në *Cryptography*;
- certifikime në *Autonomous Vechicles/Machines*;
- certifikime me fokus në sigurinë kibernetike të sistemeve industriale dhe kritike (SA/IEC *Cybersecurity Expert*);
- certifikime në mbrojtjen e sistemeve OT dhe ICS (GIAC *Global Industrial Cyber Security Professional*);
- certifikim për arkitekturën dhe sigurinë e sistemeve SCADA (*Certified SCADA Security Architect*);
- çdo certifikim tjetër të vlefshëm për menaxhimin e incidenteve të sigurisë kibernetike;

ç) Dokumentacioni i kërkuar në shkronjën "c", të pikës 5, të këtij kreu, duhet të paraqitet në kopje origjinale ose të njësuar me origjinalin.

6. AKSK-ja, brenda 1 (një) jave nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, publikon në faqen e saj zyrtare thirrjen për pjesëmarrje të ekspertëve të sigurisë kibernetike, të teknologjisë së informacionit dhe ekspertëve OT, me qëllim hartimin e listës së ekspertëve të sigurisë kibernetike, teknologjisë së informacionit dhe ekspertëve OT, të cilët do të jenë pjesë e CERT-it, ndërsa për ekspertët ndërkombëtarë thirrja do të publikohet edhe në faqet zyrtare të forumeve ndërkombëtare të sigurisë kibernetike.

7. Shpallja do të përmbajë një informacion të detajuar, në lidhje me kriteret që duhet të plotësojnë ekspertët e sigurisë kibernetike, të teknologjisë së informacionit dhe ekspertët OT, dokumentet që duhet të dorëzojnë, mënyrën dhe formën e dorëzimit të tyre.

8. Shpallja do të qëndrojë e hapur për një periudhë njëmujore.

9. Pas paraqitjes së dokumentacionit pranë AKSK-së, kjo e fundit, brenda një afati 30-ditor, do të bëjë vlerësimin e tij bazuar në plotësimin e kritereve të përcaktuara në këtë vendim, si dhe në procesin e intervistimit e më pas do të njoftojë ekspertët e përzgjedhur.

10. AKSK-ja do të hartojë listën me emrat dhe kontaktet e ekspertëve të sigurisë kibernetike, të teknologjisë së informacionit dhe ekspertët OT, nga të cilët do të përzgjidhen ekspertët që do të jenë pjesë e CERT-it.

11. Ekspertët, pjesë e listës së CERT-it, të cilët, në përmbushje të detyrave të tyre sipas përcaktimeve të këtij vendimi, do të kenë akses në sistemet e komunikimit e të informacionit të akredituara, ku trajtohet informacion i klasifikuar, kanë detyrimin për të ndjekur procedurat për pajisjen me "Certifikatë të sigurisë së personelit", në përputhje me parashikimet e legjislacionit për informacionin e klasifikuar.

12. AKSK-ja do të kryejë thirrjen për ekspertë të sigurisë kibernetike, të teknologjisë së informacionit dhe ekspertë OT brenda muajit janar të çdo viti.

II. MËNYRA E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË EKIPIT TË PËRGJIGJES NDAJ EMERGJENCAVE DHE KRIZËS SË SIGURISË KIBERNETIKE

1. CERT-i mblidhet nga AKSK-ja në rast emergjence dhe krize kibernetike për hartimin e planit të masave, menaxhimin dhe zgjidhjen e emergjencës e të krizës kibernetike.

2. Mbledhjet e CERT-it drejtohen nga drejtori i përgjithshëm i AKSK-së dhe, në mungesë të tij, nga një drejtor me profil teknik nga AKSK-ja.

3. Pranë CERT-it ngrihet e funksionon sekretariati teknik i CERT-it, i cili është përgjegjës për përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe për njoftimin e anëtarëve të CERT-it për mbledhjen. Përbërja e sekretariatit teknik të CERT-it përcaktohet me urdhër të drejtorit të përgjithshëm të AKSK-së.

4. Në situatat e emergjencave dhe të krizave kibernetike, komunikimi ndërinstitucional mbahet duke përdorur kanalet zyrtare të komunikimit, kanalet alternative, si dhe ato rezervë (*backup*). Sekretariati teknik mban procesverbalin e takimeve, minutat e takimit, ruan përmbajtjen e komunikimeve, të njoftimeve apo të kërkesave të marra e të dhëna përmes përdorimit të mjeteve të teknologjisë së informacionit.

5. Për përballimin e emergjencave dhe të krizave kibernetike, me kërkesë të CERT-it, mund të angazhohen edhe ekspertë të sigurisë kibernetike, të teknologjisë së informacionit dhe ekspertë OT nga institucione të tjera shtetërore, sipas fushës së përgjegjësisë së tyre, për t'iu përgjigjur emergjencave dhe krizave kibernetike, sipas sektorëve përkatës.

III. FUNKSIONET E EKIPIT TË PËRGJIGJES NDAJ EMERGJENCAVE DHE KRIZËS SË SIGURISË KIBERNETIKE

Funksionet e CERT-it janë, si më poshtë vijon:

a) Harton planin e masave të emergjencës e të krizës kibernetike;

b) Menaxhon dhe zgjidh emergjencat e krizën kibernetike, duke ruajtur në çdo kohë konfidencialitetin;

c) Ofron mbështetje për hartimin e rekomandimeve për të rikthyer në normalitet sistemet dhe rrjetet e informacionit në infrastrukturat e informacionit pas një incidenti në shkallë të gjerë dhe gjendjes së emergjencës e të krizës kibernetike.

IV. DISPOZITË E FUNDIT

Ngarkohen Autoriteti Kombëtar për Sigurinë Kibernetike dhe institucionet e përmendura në shkronjën "a", të pikës 2, të kreut I, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 724, datë 3.12.2025

PËR EKZEKUTIMIN E VENDIMIT TË GJYKATËS EVROPIANE PËR TË DREJTAT E NJERIUT, DATË 14.1.2025, PËR ÇËSHTJEN "IBRAHIMI DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË" (PËR KËRKESËN NR. 81057/17 DHE 4 KËRKESA TË TJERA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 46 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, "Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore", të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 14, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ekzekutimin e vendimit të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 14.1.2025, për çështjen "Ibrahimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë", për kërkesën nr. 81057/17 dhe 4 kërkesa të tjera, përfundimtar në datën 14.1.2025, sipas shumave të përcaktuara në shtojcën 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Vlerat e përcaktuara si detyrim në pikën 1, të këtij vendimi, konvertohen në lekë, në bazë të kursit të këmbimit të bankës, ku depozitohet shuma, në datën e kryerjes së pagesës.

3. Vlerat e përcaktuara si detyrim, në pikën 1, të këtij vendimi, depozitohen në një nga bankat e nivelit të dytë, në emër të ankuesve, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi, në vlerën që shteti shqiptar detyrohet, sipas vendimit përfundimtar të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, datë 14.1.2025, "Ibrahimi dhe të tjerë kundër Shqipërisë", kërkesa nr. 81057/17, për secilën kërkesë.

4. Pagimi i shumave të depozituara, sipas përcaktimeve në pikën 3, të këtij vendimi, në favor të kërkuesve nr. 81057/17 (Ibrahimi), nr. 57542/18 (Selimi), nr. 54121/21(Dedaj) dhe nr. 7386/22 (Industri Ndërtim (IN) sh.p.k), bëhet nga Ministria e Financave, pas paraqitjes së dokumentacionit të nevojshëm ligjor për kryerjen e pagesave nga buxheti i shtetit, brenda afatit 3-mujor nga dita kur vendimi i gjykatës është bërë përfundimtar.5. Në rast mospagimi brenda afatit 3-mujor, të përmendur në pikën 4, të këtij vendimi, mbi shumat e mësipërme paguhen interesa të thjeshtë, të barabartë me kursin marzhinal të huas së Bankës Qendrore Evropiane, gjatë periudhës së mospagimit, plus tre për qind.

6. Efektet financiare të parashikuara për ekzekutimin e këtij vendimi përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2025.

7. Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1
LISTA E KËRKUESVE DHE SHPËRBLIMI I DREJTË

Numri i kërkesës	**Emri i çështjes**	**Kërkuesit**	**Dëm jopasuror**	**Kostot dhe shpenzimet[1]**
Nr. 81057/17	Ibrahimi kundër Shqipërisë	Besnik Ibrahimi	3.600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro)	
57542/18	Selimi	Denis Selimi Edit Selimi	3.600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro) bashkërisht	
54121/21	Dedaj	Tom Dedaj	3.600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro)	
7386/22	Industri Ndërtim (IN) sh.p.k.	Shoqëri e themeluar më 1995 në Dibër		2000 euro (dy mijë euro)

[1] Plus çdo taksë që mund të jetë e aplikueshme mbi kostot dhe shpenzimet.

VENDIM
Nr. 725, datë 3.12.2025

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 820, DATË 13.10.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË INSTITUCIONEVE TË VARËSISË, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, e 13, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 820, datë 13.10.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të institucioneve të varësisë, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural", të ndryshuar, përmasat e pronave me numra rendorë 27 dhe 78 zëvendësohen me përmasat e përcaktuara në formularin, 1 (një) fletë, plan-rilevimin, 1 (një) fletë, dhe planimetrinë, 2 (dy) fletë, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Institucioni Qendror Shtetëror: **Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural**

Identifikoi pronën: (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi: (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emertesa e pasurisë Adresa	Sip e pasurisë (m2)	Nga Sip. Truall (m2)	Nga Sip. Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret prona/ pasuria	Institucioni me pergjegjesi administrative/ pronësi	Institucioni perdorues i pasurisë Statusi juridik i perdorimit	Inventarizuar me VKM	Te dhena te tjera (shenime te veçanta)
27	2443 FR-LIBOFSHE-55		Godine	Libofshe	50	50	50	Administrate	Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	AREB	VKM 820/2010	
78	8641 SR:D-8	Pjese e pasurise 7/348	Njesi Kati Perdhe	Sarande			251.9	Administrate	Ministria e Bujqesise dhe Zhvillimit Rural	AREB	VKM 820/2010	Trualli 1088 m2
			Njesi Kati Pare				251.9					

PLAN RILEVIMI PËR PUNIME KADASTRALE

PRONARI: SHTET | DATË 28.07.2025 | QËLLIMI: PËRDITËSIM/REGJISTRIM

VENDNDODHJA: BASHKIA FIER | DVASHK/ZVASHK FIER | ZONA KADASTRALE: 2443 | NUMRI PASURISË: | INDEX HARTE: FR-LIBOFSHE-55

TË DHËNA TE PASURISË:

LLOJI PASURISË: TRUALL | SIP. TRUALL: m² | SIPËRFAQJA GJURMËS NDËRTIMIT TË OBJEKTIT: m² | NUMRI KATEVE: ___ | NUMRI PEMËVE_____

X,Y 482383.8630 4522245.6450 — KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE — 482579.5415 4522245.6658 X,Y

X,Y 482383.8630 4522140.8249 — SHKALLA 1:1000 — 482579.5415 4522140.8708 X,Y

FOTOGRAFIMI SATELITOR SHKALLA 1:2500

SHPJEGUES

KUFIRI I PRONËS

NDËRTESA PËR PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI 1 KAT

SIP. TRUALLI 50 M2 SIP. NDERTESE 50 M2

NR.	ORIENTIMI	PËRDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARËT	ID/NIPT	SHENIME TË REALIZUESIT
1	VERI					
2	LINDJE					
3	JUG					
4	PERËNDIM					

REALIZOI PËR SUBJEKT PRIVAT:
EMRI_____ LICENCA: NR._____ DATË___
KOMPANIA:_____NIPT:_____
NËNSHKRIMI/VULA___Helena Spaho
REALIZOI PËR ASHK: DV/ASHK FIER
SPECIALISTI: Bashkim Allaraj
NËNSHKRIMI_____
KONFIRMOI: DREJTOR/PËRGJEGJËS
NËNSHKRIMI/VULA_____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:_____
Kode per teknologjine e matjeve T–Terren; Z–Zyre; O–Ortofoto; G–GPS; S–Stacion Total; D–Matje Distancash;
PERCAKTIMI KUFIRIT:_____
Kode per percaktimin e kufirit: P–Perfaqesues i Pronareve; K–Kufitaret te Gjithe; KP–Kufitaret Pjeserisht; PB–Perfaqesues Bashkie; HK–Harta Kadastrale

PRONARI/BASHKËPRONARËT–DEKLARIM MBI MARRËDHËNIET ME KUFITARËT:
MINISTRIA E BRENDSHME
PËRFAQËSUESI I INSTITUCIONIT QENDROR:
EMËR/MBIEMËR: Dritan Palnikaj NËNSHKRIMI/VULA _____
Digitally signed by Dritan Palnikaj Date: 2025.09.30

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL SEKRETARIA

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi i kufirit: T–Terren; Z–Zyre; O–Ortofoto; G–GPS; S–Stacion Total; D–Matje Distancash; P–Perfaqesues i Pronareve; K–Kufitaret te Gjithe; KP–Kufitaret Pjeserisht; PB–Perfaqesues Bashkie; HK–Harta Kadastrale





Shkalla: 1:1000

SHPJEGUES			
TRUALLI FUNKSIONAL, 1088 m²	ASHK	OBJEKT 3 KATE	REALIZOI PER ASHK: SPECIALISTI ROLAND DEVA NENSHKRIMI
GJURMA E NDËRTIMIT, 269.4 m²	nr. Fletes: A-02	Emertimi i fletesi: PLANIMETRIA E KATIT TË PARË	KONFIRMOI PER ASHK: PERGJ. SEKTORI Alban Bukaci NENSHKRIMI/VULA
NDËRTESA PËRDORET NGA MINSTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL DHE NGA MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT SIPAS PLANIMETRIVE. TRUALLI ËSHTË NË BASHKËADMINISTRIM NDËRMJET DY MINISTRIVE.	Shkalla: 1:400	PRONARI/BASHKEPRONARET: MINISTRIA E BUJQESISE DHE ZHVILLIMIT RURAL, MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT	KONFIRMOI PER INSTUTICIONIN: NENSHKRIMI/VULA
	Data e pergatitjes: 31/07/2025		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL SEKRETARIA





Shkalla: 1:1000

SHPJEGUES

TRUALLI FUNKSIONAL, 1088 m²

GJURMA E NDËRTIMIT, 269.4 m²

NDËRTESA PËRDORET NGA MINSTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL DHE NGA MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT SIPAS PLANIMETRIVE. TRUALLI ËSHTË NË BASHKËADMINISTRIM NDËRMJET DY MINISTRIVE.

ASHK	OBJEKT 3 KATE	REALIZOI PER ASHK: SPECIALISTI ROLAND DEVA NENSHKRIMI
nr. Fletes: A-01	Emertimi i fletes: PLANIMETRIA E KATIT PËRDHE	KONFIRMOI PER ASHK: PERG.I SEKTORIT NENSHKRIMI/VULA
Shkalla: 1:400	PRONARI/BASHKEPRONARET: MINISTRIA E BUJQESISE DHE ZHVILLIMIT RURAL, MINISTRIA E TURIZMIT DHE MJEDISIT	KONFIRMOI PER INSTITUCIONIN: NENSHKRIMI/VULA
Data e pergatitjes: 31/07/2025		

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL SEKRETARIA

VENDIM
Nr. 727, datë 3.12.2025

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, e 25, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit "Lista e OKB-së", që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

Në listën e shkronjës "C", të titulluar "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë të organizatave ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida", hiqen 2 (dy) individë, të renditur në shkronjën "a", në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për individët e shpallur anëtarë ose bashkëpunëtorë të organizatave ISIL (Da'esh) dhe Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

NDRYSHIME NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT

SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT

("LISTA E OKB-së")

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATAT ISIL (*Da'esh*) dhe Al-QAIDA

a) Ndryshime në "Listën e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatat ISIL (*Da'esh*) dhe *Al-Qaida":*

1. AHMAD: HUSSAIN: AL-SHARAA
2. ANAS: HASAN: KHATTAB

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personat, emrat e të cilëve janë radhitur më sipër, mbahen në Agjencinë e Inteligjencës Financiare.

VENDIM
Nr. 728, datë 3.12.2025

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR DHËNIEN E MEDALJES SË SHËRBIMIT USHTARAK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 16, të ligjit nr. 93/2022, "Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e kritereve, sipas këtij vendimi, për dhënien e medaljes së shërbimit ushtarak, me qëllim njohjen e përkushtimit e të kontributit në shërbim të interesave kombëtarë dhe kryerjen me përgjegjësi të lartë të detyrave.

2. Për përfitimin e medaljes së shërbimit ushtarak, personeli ushtarak e civil i Forcave të Armatosura duhet të plotësojë të gjitha kriteret e mëposhtme:

a) të jetë dalluar për përkushtimin dhe kontributin në shërbim të interesave kombëtarë;

b) të ketë kryer me përgjegjësi të lartë detyrat;

c) të mos ketë masë disiplinore në fuqi apo të mos ketë marrë më parë masë disiplinore për shkelje të rëndë gjatë viteve të punës në Forcat e Armatosura;

ç) të ketë kontribuar për një kohëzgjatje shërbimi në Forcat e Armatosura:

i. jo më pak se 20 (njëzet) vjet për përfitimin e medaljes së artë të shërbimit ushtarak;

ii. jo më pak se 15 (pesëmbëdhjetë) vjet për përfitimin e medaljes së argjendtë të shërbimit ushtarak;

iii. mbi 5 (pesë) vjet për përfitimin e medaljes së bronztë të shërbimit ushtarak.

3. Në raste të veçanta, kur evidentohen kontribute të jashtëzakonshme dhe të argumentuara, dhënia e njërës prej shkallëve të

medaljes së shërbimit ushtarak bëhet edhe pa plotësuar kriteret e kohëzgjatjes së shërbimit në Forcat e Armatosura, të parashikuara në shkronjën "ç", të pikës 2, të këtij vendimi.

4. Për përfitimin e medaljes së shërbimit ushtarak, ushtaraku i huaj vlerësohet vetëm për kontributin e veçantë, të vlerësuar si të rëndësishëm e të spikatur në funksion të interesave të Republikës së Shqipërisë.

5. Ngarkohen Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura dhe Kancelaria e Urdhrave dhe Medaljeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 729, datë 3.12.2025

PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DREJTORIT TË PËRGJITHSHËM TË AGJENCISË KOMBËTARE TË BREGDETIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 10/1, të kreut III, të vendimit nr. 569, datë 17.7.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kompetencave, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Bregdetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Xheni Beqaj emërohet drejtor i përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 730, datë 3.12.2025

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 450, DATË 30.6.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË MATERIALEVE DHE TË PAJISJEVE SPORTIVE, QË PËRJASHTOHEN NGA DETYRIMET DOGANORE DHE TATIMI MBI VLERËN E SHTUAR, SI DHE PROCEDURA E PËRJASHTIMIT TË TYRE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 7, të ligjit nr. 79/2017, "Për sportin", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në shtojcën që i bashkëlidhet vendimit nr. 450, datë 30.6.2021, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së materialeve dhe të pajisjeve sportive, që përjashtohen nga detyrimet doganore dhe tatimi mbi vlerën e shtuar, si dhe procedurat e përjashtimit të tyre", bëhen këto shtesa:

a) Pas pikës 39, të kreut VII, shtohen pikat 40 dhe 41, me këtë përmbajtje:

"40. Jelekë për monitorimin e performancës së lojtarëve;

41. Mbulesë fushe.";

b) Pas pikës 25, të kreut IX, shtohet pika 26, me këtë përmbajtje:

"26. Panele për trajnime dhe mure elastike për ushtrime.";

c) Pas pikës 7, të kreut XI, shtohet pika 8, me këtë përmbajtje:

"8. Pajisje ndihmëse për ndërtimin e pistës së garave (matës të lartësisë, metrik për distancat, kone sinjalizuese, kronometër elektronik me sensorë).";

ç) Pas pikës 35, të kreut XVIII, shtohen pikat 36 dhe 37, me këtë përmbajtje:

"36. Matës shpejtësie për topat;

37. Ngjitës shirit për tarafleks.";

d) Pas pikës 9, të kreut XIX, shtohen pikat 10, 11 dhe 12, me këtë përmbajtje:

"10. Pajisje për ski me patina (*roller ski*);

11. Pajisje për ski në bar;

12. Pajisje dhe veshje për *snowboard*.";

dh) Pas pikës 23, të kreut XXII, shtohen pikat 24, 25, 26, 27 dhe 28, me këtë përmbajtje:

"24. Rrjeta për fusha tenisi profesionale dhe amatore;

25. Rrjeta fundore errësimi për fusha tenisi;

26. Shtresa të llojeve të ndryshme për shtrimin e fushave të tenisit;

27. Rezinë dhe akrilik të ndryshëm për shtimin dhe lyerjen e fushave të tenisit;

28. Aksesorë të ndryshëm për fushat e tenisit (shtylla, makineta për tendosjen e rrjetave, shirita për mesin e rrjetës, pajisje për tharjen dhe pastrimin e fushave).";

e) Pas pikës 11, të kreut XXIII, shtohen pikat 12 dhe 13, me këtë përmbajtje:

"12. Robotë të dedikuar për mësimet e shahut;

13. CD dhe programe për mësimet e shahut.";

ë) Pas pikës 13, të kreut XXXVI, shtohen pikat 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20 dhe 21, me këtë përmbajtje:

"14. Polo/pantallona sportive;

15. Jelekë identifikues;

16. Kuti shahu;

17. Raketa ping-pongu;

18. Raketa tenisi;

19. Rrjeta për volejboll dhe *beachvolley*;

20. Shporta ose karroca për topat;

21. Shirit për shënimin e fushës.";

f) Pas kreut XXXIX shtohen krerët XXXX, XXXXI, XXXXII dhe XXXXIII, me këtë përmbajtje:

"XXXX. ORGANIZATAT SPORTIVE TË ARTEVE MARCIALE MIKSE

1. Doreza për arte marciale mikse;
2. Doreza për boks;
3. Mbrojtëse për dhëmbë;
4. Mbrojtëse për kërcinjtë;
5. Mbështjellëse për duar;
6. Mbrojtëse intime për meshkuj;
7. Helmetë mbrojtëse;
8. Bluza, tuta dhe rroba për stërvitje;
9. Jastëkë për goditje me këmbë;
10. Mbrojtëse për goditje;
11. Jastëkë për *kickboxing*;
12. Thasë për goditje;
13. Mbrojtëse për bërryla;
14. Mbrojtëse për gjunjë;
15. Mbrojtëse për kyçin e dorës;
16. Mbrojtëse për kyçet e këmbëve;
17. Mbrojtëse për trupin;
18. Topa për stërvitje;
19. Shtanga;
20. Pesha për shtanga;
21. Kafaz oktagonal për ndeshje;
22. Ring për boks;
23. Dyshekë për stërvitje;
24. Çantë për pajisje;
25. Material për mbështjellje dhe ngjitje;
26. Këpucë për stërvitje.

XXXXI. ORGANIZATAT SPORTIVE TË PADELIT

1. Raketa padeli;
2. Topa padeli;
3. Veshje sportive për padel;
4. Këpucë specifike për padel;
5. Rrjeta padeli;
6. Shtylla për rrjeta padeli;
7. Fusha modulare për padel;
8. Sisteme ndriçimi për fushat e padelit;
9. Karkasa metalike dhe xhami sigurie për ndërtimin e fushave të padelit;
10. Sisteme mbrojtëse dhe rrjeta sigurie;
11. Pajisje për stërvitje dhe ushtrime teknike të padelit.

XXXXII. ORGANIZATAT SPORTIVE TË TRIATHLON-it

1. Veshmbathje dhe uniforma sportive (pantallonçina për çiklizëm, kostume neopren, këpucë sportive çiklizmi, fanella verore dhe dimërore për çiklizëm, tuta sportive e mushama mbrojtëse nga shiu, kaska mbrojtëse për çiklizëm, doreza sportive);
2. Syze noti;
3. Syze për çiklizëm;
4. Biçikletë profesionale;
5. Pjesë këmbimi për biçikletat.

XXXXIII. ORGANIZATAT SPORTIVE TË HARKUT

1. Pajisje për qitjen me hark (hark dhe pjesë të tij, shigjeta, aksesorë);
2. Pajisje mbrojtëse (mbrojtëse për gjoksin, mbrojtëse për parakrahun, mbrojtëse për gishtin);
3. Pajisje shënjimi për harkun;
4. Teleskop i integruar për qitje precize;
5. Pajisje për kontrollin e largimit të shigjetës nga harku;
6. Letra me qarqe.".

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës dhe Sportit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe organizatat sportive shqiptare për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 731, datë 3.12.2025

PËR KALIMIN E FONDIT NË KUADËR TË MBËSHTETJES SË VEPRIMTARISË SË FONDACIONIT "KINOSTUDIO"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 11, të ligjit nr. 115/2024, "Për buxhetin e shtetit të vitit 2025", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e fondit, në masën 25 000 000 (njëzet e pesë milionë) lekë, në kuadër të mbështetjes së veprimtarisë së fondacionit "Kinostudio".

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, transferohet në llogarinë bankare të fondacionit "Kinostudio" dhe përballohet nga buxheti i miratuar për vitin 2025 për Ministrinë e Arsimit, në programin buxhetor 01110 "Planifikim, menaxhim dhe administrim", në llogarinë ekonomike 604. Financimi mbulon veprimtarinë për një periudhë 12-mujore.

3. Fondacioni "Kinostudio", brenda muajit dhjetor 2025, pas transferimit të fondeve duhet të paraqesë në Ministrinë e Arsimit planin e detajuar të shpenzimeve, të përgatitur në përputhje me klasifikimin ekonomik buxhetor dhe të miratuar nga këshilli drejtues i fondacionit, duke identifikuar të gjitha aktivitetet/produktet, që do të realizohen në kuadër të veprimtarisë së fondacionit "Kinostudio".

4. Fondacioni "Kinostudio" detyrohet të raportojë periodikisht mbi bazë katërmujore në Ministrinë e Arsimit për ecurinë e realizimit të aktiviteteve dhe të përdorimit të fondeve, sipas strukturës së miratuar të shpenzimeve.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe fondacioni "Kinostudio" për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 732, datë 3.12.2025

PËR LIRIM DHE EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Orjana Osmani, zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit, lirohet nga kjo detyrë dhe emërohet zëvendësministër i Arsimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA LASKU DHE TË TJERË KUNDËR SHQIPËRISË
(kërkesa nr. 6045/14)

VENDIM
STRASBURG
18 nëntor 2025

Ky vendim është përfundimtar, por mund të jetë subjekt i rishikimit redaktues.

Në çështjen Lasku dhe të tjerë kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si një Komitet i përbërë nga:

Úna Ní Raifeartaigh, *kryetar,*
Darian Pavli,
Mateja Đurović, *gjyqtarë*
dhe Olga Chernishova, *zëvendëssekretare e Seksionit,*
Duke mbajtur në konsideratë:

kërkesën (nr. 6045/14) kundër Republikës së Shqipërisë depozituar në Gjykatë, më 31 dhjetor 2013, në mbështetje të nenit 34 të Konventës për

Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa), nga 13 shtetas shqiptarë, me detajet përkatëse të listuara në tabelën bashkëlidhur (kërkuesit), të cilët u përfaqësuan nga z. E. Hicka, avokat i cili e ushtron profesionin në Tiranë;

vendimin për të njoftuar Qeverinë Shqiptare (Qeveria) e përfaqësuar nga Agjenti i saj, z. O Moçka, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, mbi ankesat në lidhje me sigurinë juridike, të drejtat e pronësisë dhe kohëzgjatjen e procedurave, dhe për të shpallur pjesën tjetër të kërkesës së papranueshme;

vërejtjet e palëve;

Pasi diskutoi me dyer të mbyllura më 14 tetor 2025,

Shpall vendimin e mëposhtëm, që u miratua në të njëjtën datë:

LËNDA E ÇËSHTJES

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Çështja ka të bëjë kryesisht me ankesën bërë në mbështetje të nenit 6 § 1 të Konventës për anulimin nga ana e autoriteteve vendase të tre vendimeve përfundimtare të komisionit të pronave, duke shkelur në këtë mënyrë parimin e sigurisë juridike.

A. Kuadri i çështjes

2. Në vitet 1996 dhe 1997, Komisioni për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronës Tiranë (Komisioni) i njohu kërkuesve të drejtat ndaj pronës së trashëguar kundrejt tre parcelave toke, me sipërfaqe në total 1,070 m^2 dhe urdhëroi rikthimin e tyre te kërkuesit. Zyra për Regjistrimin e Pronave të Paluajtshme (ZRPP) regjistroi titullin e pronësisë së tokës së kërkuesve.

3. Në vitin 1996, Bashkia Tiranë lëshoi një leje ndërtimi për kërkuesit për ndërtimin e një karburanti në truallin me sipërfaqe 700 m^2, që ishte pjesë e tokës së rikthyer nga Komisioni. Ndërtimi u realizua në bashkëpunim me kompaninë M. Në vitin 1998, ZRPP-ja regjistroi titullin e pronësisë së kërkuesve për karburantin.

4. Kërkuesit ia kaluan administrimin dhe zotërimin e karburantit kompanisë M me anë të një marrëveshjeje bashkëpunimi, me qëllim ndarjen e përfitimeve në mënyrë të barabartë.

5. Ankesat e depozituara nga kërkuesit kishin të bënin me procedura të ndryshme që ishin të ndërlidhura me njëra-tjetrën dhe kishin lidhje me të njëjtat toka.

B. Grupi i parë i procedurave

6. Në vitin 2000, kompania M. bëri një padi civile ndaj kërkuesve me anë të së cilës kërkonte njohjen e titullit të saj të pronësisë për ndërtesën dhe truallin ku gjendej ndërtesa. Kërkuesit paraqitën një kundërpadi ku kërkonin rikthimin e pronësisë. Në vitin 2004, të dyja paditë u rrëzuan nga gjykatat për arsye se marrëveshja midis palëve (shih paragrafin 4 më sipër) përbënte një pengesë në dhënien e titullit të pronësisë secilës prej palëve.

C. Grupi i dytë i procedurave

7. Në vitin 2003, kërkuesit bënë një padi civile ndaj kompanisë M. ku kërkonin që t'u paguhej pjesa e tyre e përfitimeve. Më 12 mars 2013, Gjykata e Apelit Tiranë (Gjykata e Apelit), e pranoi padinë. Më 22 nëntor 2022, Gjykata e Lartë e la në fuqi këtë vendim, me anë të së cilit njihej detyrimi i kompanisë M. që t'i paguante kërkuesve pjesën e tyre të përfitimeve.

8. Më 13 korrik 2021, kërkuesit u ankuan në Gjykatën e Lartë për kohëzgjatjen e këtyre procedurave. Më 26 korrik 2023, Gjykata e Lartë e rrëzoi ankesën në mbështetje të neneve 399/1 e të tjerë të Kodit të Procedurës Civile, me arsyetimin se çështja ishte gjykuar tashmë dhe se kohëzgjatja e tepërt e procedurave i atribuohej reformës në sistemin e drejtësisë në Shqipëri.

D. Grupi i tretë i procedurave

9. Pas ndryshimit në Ligjin për Pronat në vitin 2007 (shih paragrafin 16 në vijim) drejtorit të Agjencisë për Rikthimin dhe Kompensimin e Pronave (Agjencia), që kishte pasuar Komisionin, i ishte dhënë kompetenca që të shqyrtonte dhe anulonte, me anë të mocionit të tij ose saj, vendimet e komisioneve dhe të degëve rajonale të dikurshme të Agjencisë. Për shqyrtimin nuk u parashikuan afate.

10. Më 27 nëntor 2007, Agjencia anuloi tre vendimet e Komisionit në lidhje me rikthimin e tokave me sipërfaqe prej 1,070 m^2 për kërkuesit me arsyetimin se komisionit përkatës të dikurshëm i mungonte juridiksioni dhe vendimi duhej të ishte marrë nga një komision i posaçëm. Agjencia argumentoi se Ligji për Pronat i vitit 1993 i jepte komisioneve autoritetin të njihnin të drejtën ndaj pronës dhe të vendosnin për rikthimin e saj, por jo autoritetin për të urdhëruar rikthimin e pronës. Gjithashtu, sipërfaqja e tokës në fjalë nuk mund të rikthehej pavarësisht se ishte e regjistruar si pronë shtetërore (shih paragrafin 18 në vijim). Vendimi me

anë të së cilit kërkuesit u njiheshin të drejtat e trashëguara mbeti në fuqi.

11. Në fund të vitit 2007, kërkuesi Bledar Lasku dhe A. K. (kërkuesit Shpresa Kekezi dhe Teri Kekezi trashëgimtarët e tij) e kundërshtuan vendimin e Agjencisë pranë Gjykatës së Rrethit Tiranë (Gjykata e Rrethit), e cila e pranoi padinë e tyre, duke gjykuar se anulimi mbështetej në Kodin e Procedurës Administrative, që kishte hyre në fuqi tre vite pas vendimit të Komisionit. Më 15 shkurt 2010, ai vendim u pushua nga Gjykata e Apelit, që e rrëzoi padinë. Më 28 qershor 2012, Gjykata e Lartë la në fuqi vendimin e Gjykatës së Apelit. Më 24 prill 2013, Gjykata Kushtetuese gjeti shkelje në të drejtën e kërkuesve për një gjykim të drejtë nga Gjykata e Lartë dhe e ridërgoi çështjen për rigjykim. Pas rigjykimit, më 22 janar 2014, Gjykata e Lartë e rrëzoi apelimin për pikat e ligjit paraqitur nga kërkuesit për herë të dytë, në mbështetje të nenit 472 të Kodit të Procedurës Civile (pa arsye të vlefshme për apelim).

12. Më 10 prill 2015, Gjykata Kushtetuese e rrëzoi ankesën kushtetuese të kërkuesve duke konstatuar se në periudhën kur u gjykua çështja nga Gjykata e Apelit, autoriteti i Agjencisë për të shqyrtuar vendimet përfundimtare ishte ende në fuqi, dhe se vendimet e Gjykatës Kushtetuese nuk kishin efekt prapaveprues (shih paragrafin 16 në vijim).

E. Grupi i katërt i procedurave

13. Në vitin 2008, kërkuesit paraqitën një padi të re ndaj kompanisë M. Gjykata e Rrethit vendosi të ndërpriste marrëveshjen e tyre me kompaninë, por rrëzoi padinë e kërkuesve për rikthimin e pronës. Ai vendim u la në fuqi nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë në vitet 2011 dhe 2022, respektivisht. Më 29 maj 2023, ankesa kushtetuese pasuese e kërkuesve ndaj këtyre procedurave u rrëzua. Edhe pse Gjykata Kushtetuese vendosi se kohëzgjatja e grupit të dytë të procedurave pranë Gjykatës Kushtetuese ishte e tepërt (shih paragrafin 8 më sipër), ajo gjykoi se nuk kishte juridiksionin për të akorduar kompensim.

F. Procedurat e legalizimit

14. Në një periudhë të pacaktuar, kompania M. bëri një ndërtim pa leje në truallin e kërkuesve, si shtesë të strukturës ekzistuese (shih paragrafin 3 më sipër), dhe në vitin 2013, ai ndërtim u legalizua. Në vitin 2014, shteti i shiti kompanisë 595.8 m^2 truall, mbi të cilin pozicionohej ndërtimi i legalizuar. Ky truall ishte pjesë e tokës që kërkohej nga kërkuesit. Kërkuesit nuk i kundërshtuan procedurat e legalizimit apo kontratën e shitjes.

15. Në vitin 2016, ZRPP-ja i hoqi emrat e kërkuesve nga lista e pronarëve të ndërtesës ekzistuese dhe e regjistroi atë si pronë të kompanisë M. Kërkuesit paraqitën një ankesë administrative ndaj masave të ZRPP-së, megjithatë ata nuk kanë nisur ende asnjë procedurë.

II. LIGJI DHE PRAKTIKA PËRKATËSE E BRENDSHME

16. Më 26 maj 2010 dhe më 6 tetor 2011, Gjykata Kushtetuese konstatoi se ndryshimet që i jepnin Agjencisë pushtetin të shqyrtonte dhe rrëzonte vendimet e formës së prerë të Komisioneve të mëparshme ishin në shkelje të Kushtetutës dhe, në vijim, ishin anuluar. Gjykata Kushtetuese konstatoi se këto ndryshime shkelin, ndër të tjera, parimin e sigurisë juridike dhe të drejtën e pronësisë. Një përmbledhje e detajuar e dispozitave përkatëse të brendshme dhe praktikës gjyqësore janë bërë në *Gaba kundër Shqipërisë* (nr. 33369/17, §§ 43–56, 17 dhjetor 2024).

17. Parashikimet përkatëse në lidhje me mjetin kompensues për kohëzgjatjen e procedurave përcaktohet në *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë* (nr. 43391/18 dhe 17766/19, § 37, 12 tetor 2021) dhe *ARB sh.p.k. dhe të tjerë kundër Shqipërisë* (nr. 39860/19 dhe 2 të tjerë, §§ 65–67, 27 maj 2025).

18. Agjencia, në vendimin e saj të anulimit, iu referua vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM-ja) nr. 528/1996, ku përcaktoheshin procedurat për kompensimin e pronave të pozicionuara në zonat turistike.

VLERËSIMI I GJYKATËS

I. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

A. Siguria juridike

1. Pranueshmëria

19. Qeveria argumentoi se vetëm Bledar Lasku dhe A. K. (shih paragrafin 11 më sipër) kishin kontestuar vendimin e Agjencisë pranë gjykatave vendase, dhe se për këtë arsye kërkuesit e tjerë nuk kishin statusin e viktimës.

20. Gjykata vëren se kërkuesit ndërmorën një sërë procedurash ndaj autoriteteve të brendshme dhe kompanisë M., në lidhje me sipërfaqet e tokave në fjalë. Grupi i tretë i procedurave (shih paragrafët 9–12 më sipër), që kanë të bëjnë me këtë ankesë, u iniciua për të mbrojtur të drejtat pronësore të të gjithë trashëgimtarëve, dhe konstatimet e gjykatave

të brendshme kishin të bënin me rikthimin e të tri sipërfaqeve të tokës. Për këtë arsye, Gjykata vlerëson se autoriteteve të brendshme iu jepej mundësia për të korrigjuar shkeljen e pretenduar për të gjithë kërkuesit. Gjithashtu, të gjithë kërkuesit kanë demonstruar një qasje proaktive ndaj pronave konkrete, siç provohet nga pjesëmarrja e tyre në procedurat e tjera për të njëjtat sipërfaqe toke. Interesat pronësore të kërkuesve të tjerë ndikohen nga vendimi i Agjencisë dhe vendimet e gjykatave përkatëse. Për këtë arsye, në rrethanat e çështjes konkrete, argumenti i qeverisë për këtë aspekt duhet të rrëzohet.

21. Gjykata vëren se kjo ankesë nuk është qartazi e pambështetur në fakte sipas interpretimit të nenit 35 §§ 3 (a) të Konventës apo e papranueshme për shkaqe të tjerë. Për këtë arsye, ajo duhet të shpallet e pranueshme.

2. Meritat

22. Kërkuesit parashtruan se të tre vendimet e Komisioneve të viteve 1996 dhe 1997 ishin të formës së prerë. Për këtë arsye, anulimi i tyre shkelte parimin e sigurisë juridike. Autoriteti i Agjencisë për të shqyrtuar vendimet e Komisionit *proprio motu* ishte shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese në kohën e gjykimit të çështjes nga Gjykata e Lartë.

23. Qeveria argumentoi se gjykatat vendase kishin vepruar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi në periudhën përkatëse. Gjithashtu, ajo shtoi se vendimet ishin anuluar me arsyetimin se ato ishin dhënë në kundërshtim me ligjin.

24. Gjykata vlerëson se kjo çështje paraqet problematika të ngjashme me ato në çështjen *Gaba* (cituar në sipër), ku u konstatua një shkelje e të drejtës së kërkuesit për gjykim të drejtë, sipas nenit 6 § 1 për anulimin e një vendimi të formës së prerë të komisionit për rikthimin e pronave pa rrethana substanciale dhe bindëse. Në atë çështje, Gjykata konstatoi si problematik faktin se Avokati i Shtetit mund të kishte kërkuar, në mënyrë të papërcaktuar, shqyrtimin e vendimit të formës së prerë të një komisioni të mëparshëm mbi çfarëdo arsyesh juridike të një natyre të përgjithshme, dhe jo vetëm mbi arsye të rrethanave substanciale dhe detyruese (*idem*., §§ 88–89).

25. Në çështjen konkrete, titujt e pronësisë së kërkuesve u anuluan rreth dhjetë vite pasi vendimet përkatëse të Komisionit ishin bërë të formës së prerë. Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë konfirmuan arsyetimin e Agjencisë se komisionit përkatës i mungonte juridiksioni për të urdhëruar rikthimin e tokës së kërkuesve, duke iu referuar VKM-së nr. 528/1996 (shih paragrafin 18 më sipër), dhe duke qenë se toka konkrete nuk ishte e përshtatshme ligjërisht për rikthim. Megjithatë, gjykatat nuk mundën të shpjegonin zbatueshmërinë e asaj VKM-je për çështjen e kërkuesve, duke pasur parasysh se ajo i referohej specifikisht zonave turistike dhe faktin se trualli në fjalë nuk ishte përcaktuar si i tillë. Për këtë arsye, gjykatat nuk ofruan arsye të qarta, ose nuk përcaktuan një bazë ligjore të qartë se përse trualli në fjalë nuk ishte i përshtatshëm për rikthim.

26. Gjithashtu, pasi trualli i ishte marrë kërkuesve, një pjesë e tij iu transferua palëve të tjera private, të cilat vazhdojnë ta zotërojnë edhe sot (shih paragrafin 14 më sipër). Si rezultat, qeveria nuk dha një arsye bindëse për revokimin e vendimeve të komisioneve për rikthimin e pronës. Gjithashtu, duhet të theksohet se shqyrtimi administrativ dhe gjyqësor nuk ngrinte dyshime për vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga kërkuesit për të provuar pronësinë e paraardhësit të tyre, dhe as ndonjë provë tjetër që mund të provonte keqbesim nga ana e tyre. Vendimi për njohjen e të drejtave të tyre për tre sipërfaqet e tokave prej 1,070 m^2 është ende në fuqi, pasi anulimi kishte të bënte vetëm me rikthimin e tyre *in natura*.

27. Për këtë arsye, qeveria nuk ka provuar se ekzistonin rrethana substanciale dhe bindëse që justifikonin anulimin e vendimeve në fjalë dhe që do të mund të bindnin Gjykatën të arrinte një përfundim tjetër nga ai në çështjen *Gaba* (cituar më sipër, §§ 89–92). Në këto rrethana është shkelur parimi i sigurisë juridike i parashikuar në nenin 6 § 1 të Konventës.

B. Kohëzgjatja e procedurave

28. Kërkuesit u ankuan edhe se grupi i dytë i procedurave nuk është përfunduar brenda një "afati të arsyeshëm". Ata argumentuan se Gjykata Kushtetuese duhej t'iu kishte dhënë kompensim dhe jo të konstatonte vetëm shkeljen e të drejtës së tyre.

29. Qeveria parashtroi se kërkuesit nuk kishin paraqitur ndonjë kërkesë për kompensim pranë Gjykatës së Rrethit në mbështetje të neneve 399/6 dhe 399/10 të Kodit të Procedurës Civile (shih referencën në paragrafin 17 më sipër), dhe për pasojë nuk kishin shteruar mjetet e brendshme.

30. Gjykata Kushtetuese konstatoi se kërkuesve iu ishte shkelur e drejta që çështja e tyre të dëgjohej

brenda një afati të arsyeshëm pranë Gjykatës së Lartë në grupin e dytë të procedurave. Në mbështetje të neneve 399/6 dhe 399/10 të Kodit të Procedurës Civile, ata duhej të kishin paraqitur një kërkesë për kompensim pranë Gjykatës së Rrethit. Në parim, Gjykata ka konstatuar se mjeti kompensues për kohëzgjatjen e tepërt të procedurave ishte një mjet efikas (shih *Bara dhe Kola,* §§ 110–18, dhe *ARB sh.p.k. dhe të tjerë*, § 192, të dy cituar më sipër). Kërkuesit nuk e kanë shfrytëzuar këtë mjet. Për këtë arsye, ankesa në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave duhet të rrëzohet në mbështetje të nenit 35 §§ 1 dhe 4 të Konventës për mosshterim të mjeteve të brendshme.

II. PRETENDIM PËR SHKELJE TË NENIT 1, TË PROTOKOLLIT NR. 1

31. Kërkuesit u ankuan edhe se anulimi i vendimeve të Komisionit të viteve 1996 dhe 1997 kishte shkaktuar shkeljen e nenit 1, të Protokollit nr. 1 të Konventës. Kjo ankesë nuk është e pambështetur në fakte sipas interpretimit të nenit 35 § 3 (a) të Konventës, dhe as nuk është e papranueshme për arsye të tjera. Për këtë arsye, ajo duhet të shpallet e pranueshme.

32. Gjykata vëren se vendimet e viteve 1996 dhe 1997, që ishin të formës së prerë, kishin të bënin me titujt e pronësisë së kërkuesve ndaj që ishin shpronësuar prej paraardhësve të tyre të ndjerë (shih paragrafin 2 më sipër). Titulli i pronësisë së kërkuesve ishte regjistruar më pas pranë Regjistrit të Tokës dhe ata ushtronin të drejtat e pronës ndaj saj. Për këtë arsye, ajo e konsideron kërkesën e kërkuesve ndaj atij trualli të mirëpërcaktuar në juridiksionin e brendshëm për t'u cilësuar si "zotërim" i zbatueshëm sipas nenit 1, të Protokollit nr. 1 (shih, për shembull, *Ramadhi dhe të Tjerë kundër Shqipërisë,* nr. 38222/02, § 71, 13 nëntor 2007 dhe *Vikentijevik kundër ish-Republikës së Maqedonisë,* nr. 50179/07, § 60, 6 shkurt 2014).

33. Prishja e vendimeve të formës së prerë për rikthimin shkakton një ndërhyrje në pasuritë e kërkuesve (shih *Nelyubin kundër Rusisë,* nr. 14502/04, § 32, 2 nëntor 2006, dhe *Vikentijevik*, cituar më sipër, § 61). Për këtë arsye, duhet të përcaktohet nëse ndërhyrja për të cilën është bërë ankesa ishte e ligjshme, dhe nëse po, nëse ishte në përpjesëtim me qëllimin legjitim të ndjekur.

34. Gjykata vëren se kjo ankesë lidhet ngushtë me ankesën e shqyrtuar në mbështetje të nenit 6 § 1, në lidhje me anulimin e vendimeve të komisionit (shih paragrafët 22–27 më sipër) (shih *Vrioni dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 2141/03, §§ 74–75, 24 mars 2009). Pasi konstatoi se autoritetet vepruan në shkelje të nenit 6 § 1 të Konventës, Gjykata vëren se anulimi i tre vendimeve të formës së prerë të Komisionit pa rrethana substanciale dhe bindëse, në një mënyrë që nuk ishte në pajtim me parimin e sigurisë juridike, i zhgënjeu kërkuesit për sa i përket vendimeve të rikthimit, dhe i privuan ata nga mundësia për të zbatuar titujt e tyre të pronësisë ndaj pronës.

35. Për këtë arsye, ishte shkelur neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës.

ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

36. Kërkuesit kërkuan 3,240,894 euro për dëmin material dhe jomaterial dhe 20,000 euro për kostot dhe shpenzimet e bëra pranë gjykatave të brendshme dhe pranë Gjykatës.

37. Qeveria i kundërshtoi këto kërkesa si të pajustifikuara.

38. Gjykata vlerëson se kërkuesit duhet të vendosen sa më shumë të jetë e mundur në një situatë ekuivalente me atë në të cilën do të gjendeshin nëse nuk do të ishte shkelur neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës, nëse shteti i paditur do të rikthente titullin e tyre të pronësisë për pronën në fjalë dhe t'ia kthente atë (duke përfshirë rihapjen e procedurave të brendshme, nëse kjo do të ishte e zbatueshme). Në të njëjtën kohë, duke iu referuar rrethanave të çështjes, është e mundur që *restitutio in integrum* mund të mos jetë i realizueshëm (krahaso me *Vrioni*, cituar më sipër, § 83). Rrjedhimisht, nëse qeveria nuk mund të garantojë rikthimin, qoftë plotësisht apo pjesërisht, kërkuesit do të duhet të marrin një kompensim monetar të përshtatshëm (të përllogaritur në përputhje me kërkesat e brendshme për vlerësimin e pronës në vlerën aktuale dhe praktikën e Gjykatës), ose dhënien e një prone të ngjashme sipas vlerës aktuale (krahaso me *Brumărescu kundër Rumanisë* (gjykim i drejtë) [DHM], nr. 28342/95, §§ 19–24, GJEDNJ 2001 I; *Drozdyk dhe Mikula kundër Ukrainës*, nr. 27849/15 dhe 33358/15, §§ 60–62, 24 tetor 2024; dhe *Jella dhe të Tjerë kundër Shqipërisë* [Komiteti], nr. 7564/07, § 32, 5 mars 2024).

39. Gjykata u akordon kërkuesve së bashku 3,600 euro për dëmin jomaterial plus çdo taksë që mund të tarifohet.

40. Për sa u përket dokumenteve në zotërimin e saj, Gjykata e vlerëson të arsyeshme që t'i akordojë

kërkuesve së bashku 3,000 euro për kostot dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me procedurat pranë saj, plus çdo taksë që mund të tarifohet.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT

1. E shpall ankesën sipas nenit 6 § 1 të Konventës, në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave të papranueshme, dhe ankesat në lidhje me shkeljen e sigurisë juridike sipas nenit 6 të Konventës dhe nenit 1, të Protokollit nr. 1 të pranueshme;

2. Gjykon se është shkelur neni 6 § 1 dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 të Konventës për sa i përket anulimit nga ana e autoriteteve të brendshme të vendimeve të Komisionit, të viteve 1996 dhe 1997, për rikthimin e pronës për kërkuesit.

3. Gjykon

a) se shteti i paditur duhet të garantojë, me anë të mjeteve të duhura dhe brenda dymbëdhjetë muajve, rikthimin e plotë të titullit të pronësisë së kërkuesve për sipërfaqet e tokës në fjalë, ose t'iu ofrojë kërkuesve kompensimin monetar ose një pronë të ngjashme;

b) se shteti i paditur duhet t'i paguajë së bashku kërkuesve shumat e mëposhtme, që duhet të konvertohen në monedhën e shtetit të paditur në normën në datën e shlyerjes:

i. 3,600 euro (tre mijë e gjashtëqind euro), plus çdo taksë që mund të tarifohet për dëmin jomaterial;

ii. 3,000 euro (tre mijë euro), plus çdo taksë që mund t'i tarifohet kërkuesve për kostot dhe shpenzimet;

iii. se që nga përfundimi i periudhës tremujore të sipërpërmendur deri në shlyerje, interesi i thjeshtë do të duhet të paguhet për shumat e mësipërme në normën e barasvlershme me normën margjinale të huadhënies së Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mosshlyerjes plus tre pikë përqindje.

4. Rrëzon pjesën tjetër të kërkesës së kërkuesve për shpërblim të drejtë.

Hartuar në anglisht dhe njoftuar me shkrim më 18 nëntor 2025, në mbështetje të Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Olga Chernishova ZËVENDËSSEKRETARE

Úna Ní Raifeartaigh KRYETAR

SHTOJCË

Nr.	Emri i kërkuesit	Viti i lindjes/regjistrimit	Kombësia	Vendbanimi
1.	Bledar LASKU	1968	Shqiptare	Tiranë
2.	Meri IKONOMI	1948	Shqiptare	Tiranë
3.	Shpresa KEKEZI	1963	Shqiptare	Tiranë
4.	Teri KEKEZI	1997	Shqiptare	Tiranë
5.	Aleksandra LASKU	1928	Shqiptare	Tiranë
6.	Ingrid LASKU	1964	Shqiptare	Tiranë
7.	Kostandin LASKU	1961	Shqiptare	Tiranë
8.	Rezarta NGJELA	1961	Shqiptare	Tiranë
9.	Dhimiter SHKURTI	1957	Shqiptare	Tiranë
10	Donika SHKURTI	1954	Shqiptare	Tiranë
11.	Jani SHKURTI	1957	Shqiptare	Tiranë
12.	Leandro SHKURTI	1987	Shqiptare	Tiranë
13.	Roland SHKURTI	1981	Shqiptare	Tiranë

URDHËR
Nr. 1255, datë 26.11.2025

PËR SHFUQIZIMIN E URDHRAVE TË MINISTRIT TË BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL NR. 561, DATË 4.6.2025, NR. 565, DATË 5.6.2025, NR. 574, DATË 9.6.2025, NR. 584, DATË 11.6.2025, NR. 590, DATË 13.6.2025, NR. 591, DATË 14.6.2025, NR. 606, DATË 18.6.2025, NR. 613, DATË 23.6.2025, NR. 614, DATË 23.6.2025, NR. 618, DATË 25.6.2025, NR. 627, DATË 26.6.2025, NR. 630, DATË 27.6.2025, NR. 632, DATË 30.6.2025, NR. 734, DATË 30.7.2025

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, nenit 113 të Kodit të Procedurave Administrative dhe shkronjës "d", të nenit 28, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Shfuqizimin e urdhrave të Ministrit të Bujqësisë, si më poshtë:

a) urdhri nr. 561, datë 4.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

b) urdhri nr. 565, datë 5.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

c) urdhri nr. 574, datë 9.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

ç) urdhri nr. 584, datë 11.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

d) urdhri nr. 590, datë 13.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

dh) urdhri nr. 591, datë 14.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

e) urdhri nr. 606, datë 18.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

ë) urdhri nr. 613, datë 23.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

f) urdhri nr. 614, datë 23.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

g) urdhri nr. 618, datë 25.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

gj) urdhri nr. 627, datë 26.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

h) urdhri nr. 630, datë 27.6.2025, "Për ndalimin e përkohshëm të lëvizjes së kafshëve të gjalla të llojit dhen dhe dhi në territorin e Republikës së Shqipërisë";

i) urdhri nr. 632, datë 30.6.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël";

j) urdhri nr. 734, datë 30.7.2025, "Për marrjen e masave kufizuese për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjes së murtajës së ruminantëve të vegjël".

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinarisë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE
ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

URDHËR
Nr. 1269, datë 26.11.2025

PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E KATALOGUT KOMBËTAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 29, të ligjit nr. 10 416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e formës dhe përmbajtjes së Katalogut Kombëtar, sipas shtojcës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.

2. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Drejtoria e Politikave të Shëndetit të Bimëve, Farërave, Fidanëve dhe Plehrave.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Andis Salla

Shtojca 1

I. PËRMBAJTJA E KATALOGUT KOMBËTAR

Lista e varieteteve

1. Drithëra
Tërshëra (Avena sativa L.)
Elbi (Hordeum vulgare L.)
Gruri i butë (Triticum aestivum)
Grurë i fortë (Triticum durum)
Thekra (Secale cereal L.)
Orizi (Oryza sativa L.)
Misri (Zea Mays L.)

2. Foragjere
Jonxha (Medicago sativa L.)
Tërfili Aleksandrin (Trifolium alexandrium L.)
Batha foragjere (Vicia faba L.)
Lakra foragjere (Brassica oleracea L.)
Sorgum për kokërr (Sorgum bicolor L.)

3. Perime
Domatja (Solanum lycopersicum L.)
Trangulli (Cucumis sativus L.)
Speci (Capsicum annuum L.)
Patëllxhani (Solanum Melongena L.)
Lakra koke (Brassica Oeracea L.)
Lulelakra (Brassica Oleracea L.)
Qepa (Allium cepa L.)
Rikla (Raphsanus sativus L.)
Hudhra (Allium sativum L.)
Panxhari i sallatës – i kuq (Beta vulgaris L.)
Rrepa (Brassica rapa L.)
Karota (Daucus Carota L.)
Kungulli (Cucurbita pepo L.)
Shalqiri (Citrillus lanatus L.)
Pjepri (Cucumis melo L.)
Sallata (Lactuca sativa L.)
Bizelja (Pisum sativum L.)
Spinaqi (Spinacea oleracea L.)
Bamja (Hibiscus esculentus)
Preshi (Allium Porrum L.)
Batha (Vicia faba L. var. major)
Perime të tjera
Fasulja (Phaseolus vulgaris L.)
Fasulja pllaqi (Phaseolus coccineus L.)
Patatja (Solanum tuberosum L.)

4. Bimë industriale
Duhani (Nicotiana tabacum)
Panxhar sheqeri (Beta vulgaris L.)
Pambuku (Gossypium hirsutum)
Soja (Glycin Max.L .Merrill)
Luledielli (Helianthus annuus L.)
Bimë eterovajore

5. Bimë aromatike dhe mjekësore

6. Pemë frutore
Hardhia (Vitis vinifera)
Ulliri (Olea Europaea)
Portokalli (Citrus sinensis L.)
Mandarina (Citrus reticulata)
Limoni (Citrus limon L.)

7. Drurë pyjorë

8. Drurë dhe shkurre dekorative

Sqarime të përgjithshme për Katalogun Kombëtar

1. Kolona CV/H përdoret, gjithmonë, për të treguar statusin gjenetik: CV = varietet i pastër, H = hibrid.

2. Tipi biologjik përcakton mënyrën e rritjes dhe ciklin jetësor.

3. Hershmëria është, gjithmonë, periudha nga mbjellja deri në korrje/vjelje, edhe për pemët dhe bimët dekorative mund të tregojë vitin e parë të prodhimit.

4. Përdorimi është specifik për grupin e bimëve (ushqim, silazh, industrial, aromatik, dekorativ).

5. Origjina tregon nëse varietetet janë autoktone, të huaja ose të krijuara në vend.

II. FORMA E KATALOGUT KOMBËTAR

Kodi ESHFF	Kodi UPOV	Identifikimi i varietetit					Origjina	Seleksioneri	Përgjegjësi	Datë regjistrimi	Datë riregjistrimi
		Emri	Tipi biologjik	CV/H	Hershmëria	Përdorimi					

KËRKESË
Nr. 1180/6, datë 3.12.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën, "Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit, 'Ndërtim i rrugës 'Bexhet Hyti' në z.k. 2654'", me vlerë totale paraprake 936,355.66 (nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Bashkia Elbasan.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur.

Vlerësimi për pasuritë e llojit "arë" dhe "truall" është bërë bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë".

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Elbasan, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit 936,355.66 (nëntëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e treqind e pesëdhjetë e pesë pikë gjashtëdhjetë e gjashtë) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

LISTA PARAPRAKE E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "NDËRTIM I RRUGËS 'BEXHET HYTI' NË ZK. 2654"

Nr.	Pronari													Vleršimet për shpronësim										Shënime (D+E kufizime hipotekore, barrë mbi pasurinë etj.)
														"Arë"			"Truall"			"Ndërtesë"			Vlerat e kulturave bujqësore dhe dru-frutorëve		Vlera totale (lekë)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	"Arë" (m²)	"Truall" (m²)	"Ndërtesë" (m²)	Volumi	Faqe	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Sipërfaqja (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera (lekë)	Vlera e kulturës bujqësore (lekë)	Vlera e dru-frutorëve (lekë)		
	A	B	C	Ç	D	E	F	G	H	I	J	K	L	M	N	O	P	Q	R	S	T	U	V	Y	Z
1	SERVET ILMIE	MUSA ZENEL	TANUSHI TANUSHI	2654	1157/3	Truall	250	-	250.00	104.50	3	89	-	-	-	13.50	269	3,631.50	-	-	-	-	-	3,631.50	Ndërtesë dykatëshe: sip. katit përdhe=43.2m² (banim)+ 61.3 m² (soc-eko) - sip. e katit parë=124.55 m².
2	FAIK	MUSA	TANUSHI	2654	1157/2	Truall	250	-	250.00	88.80	3	88	-	-	-	8.00	269	2,152.00	-	-	-	-	-	2,152.00	Ndërtesë dykatëshe: sip. katit përdhe=88.8 m² –sip. e katit parë=124.55 m².
3	RAMAZAN HAXHIRE	MUSA MUSTAFA	DUKA DUKA	2654	1214	Arë+truall	1000	-	172.73	152.60	1	97	3.80	222	843.60	-	-	-	-	-	-	-	-	843.60	Regjistrohet leje ndërtimi me ref. 0389 dule konxjuar llojin e pasurisë në arë+truall për ndërtese dykatëshe, kati përdhe njësi shëbimi 152.6 m², kati i parë banim 156.3 m² me truall 172.73 m².
4	FIQIRET	JAKUP	MUZHAQI	2654	6/2	Truall	289.5	-	289.50	128.10	1	33	-	-	-	9.44	269	2,539.36	-	-	-	-	-	2,539.36	Godinë banimi dykatëshe: -kati përdhe=128.1m² - kati parë=128.5 m².
5	PETRAQ	PANDI	GUXHO	2654	1480	Truall	20287	-	20,287.00	10,854.30	3	237	-	-	-	992.80	269	267,063.20	-	-	-	-	-	267,063.20	Reg. 00820, dt. 11.8.2021 Hipotekë ligjore e kreditë së dhënë nga institucionet bankare. Nr. kont. 2010/945, datë 11.8.2021, 20 vite. Banka e parë e investimeve Albania First Investment reg. 00821, datë 14.6.2023 hipotekë ligjore e kreditë së dhënë nga institucionet bankare. Nr. kont. 3283/1988, datë 14.6.2023, 20 vite. Banka e parë e investimeve Albania First Investment reg. 00826. datë 14.10.2024, hipotekë ligjore e kreditë së dhënë nga institucionet bankare. Nr. kont. 5678/3353, datë 11.10.2024, 20 vite. Banka e parë e investimeve Albania First Investment
6	DURIM DRITA DORAIDA ERVIN	 KADRI FLAMUR FLAMUR	PESHTANI GEDAJ KAFEXHIU GEDAJ	2654	1590	Truall	15364	-	15,364.00	875.00	3	222	-	-	-	2,454.00	269	660,126.00	-	-	-	-	-	660,126.00	
	SHUMA PARAPRAKE														843.60			935,512.06					936,355.66	

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2025

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 112 lekë

Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Date:2025/12/09 14:13:06 +02'00'
746f379b01864616911ecfebb690bcde

Shënim : Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë të një proçedure automatike nga një sistem elektronik (Qendra e Botimeve Zyrtare)